



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
DREJTORIA EKONOMIKE, BURIMEVE NJERËZORE  
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RELACION

**PËR MONITORIMIN E BUXHETIT PERIUDHA JANAR – DHJETOR 2025**

**1. Hyrje**

Misioni i Gjykatës Kushtetuese është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimit përfundimtar të saj. Gjykata Kushtetuese si një organ kushtetues i pavarur kontribuon për forcimin e shtetit të së drejtës, nëpërmjet vendimmarrjes për ndërtimin e një shteti të lirë, demokratik e paqedashës, duke garantuar respektimin e të drejtave kushtetuese të çdo shtetasi, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese në konfliktin e kompetencave ndërmjet pushteteve, pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, kushtetueshmërinë e partive, organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre.

Buxheti i akorduar për programin 03320, “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP), të hartuar gjatë procesit të PBA 2024-2026 dhe të miratuar për buxhetin e vitit 2025. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim realizimin e një procesi gjyqësor të pavarur, transparent në mbrojtje të kushtetutës dhe të drejtave themelore të njeriut nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore, elektronike dhe kushteve të punës të gjykatës për krijimin e kushteve optimale të punës e sigurisë për gjyqtarët dhe administratën.

Programi konsiston në mbështetjen buxhetore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve e aktiviteteve buxhetore për mbështetjen e shërbimeve gjyqësore ndaj publikut me përmirësimin e infrastukturës së gjykatës dhe plotësimin e nevojave për mallra e shërbime.

**2. Informacion buxhetor i agreguar**

Gjatë vitit 2025, me shkresën nr. 125 prot., datë 06.02.2025 është kërkuar çelja e fondit të veçantë në zbatim të tabelës 1, të Udhëzimit Plotësues Nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e

buxhetit të vitit 2025”, i cili është miratuar dhe detajuar me shkresën e MF, nr. 2928/2 prot., datë 24.02.2025.

Në këtë periudhë, është kërkuar edhe rialokim fondi nga llogaria 602 në llogarinë 606, në shumën 305,000 Lekë për kompensimin e funksionarëve përfitues të telefonisë celulare sipas pikës 5 të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, dhe kërkesa është miratuar me shkresën nr. 6271/1 prot, datë 17.04.2025, protokolluar në Gjykatën Kushtetuese me nr.346/1 prot., datë 18.04.2025. Gjithashtu gjatë vitit 2025 janë kërkuar disa shtesa në llogarinë ekonomike 606 – fond i veçantë, për shkak të daljes në pension të një punonjësi (miratuar nga MF me shkresën nr. 15295/1 prot., datë 03.11.2025), si dhe për kryerjen e pagesave kalimtare pas largimit nga funksioni për dy zyrtarë të Gjykatës Kushtetuese (miratuar nga MF me shkresën nr. 14504/3 prot., datë 12.11.2025 dhe shkresën nr.17091/1 prot., datë 16.12.2025).

Në zërin Investime Kapitale (Art. 231) - për nevoja të institucionit dhe me qëllimin kryesor realizimin e produkteve të parashikuar, si dhe përdorimin sa më eficient të fondeve buxhetore janë kërkuar rialokime në zërin Investime Kapitale (Art. 231), ndërmjet produkteve, të cilat janë miratuar nga ana e Ministrisë së Financave.

Në mënyrë të detajuar buxheti final pas akordimeve dhe rialokimeve gjatë vitit 2025 paraqitet në tabelën më poshtë:

	<i>Në lekë</i>
<b>Buxheti fillestar</b>	<b>262,000,000</b>
Plani rishikuar në llog 600 - Paga	179,205,000
Plani rishikuar në llog 601 - Sigurime	20,295,000
Plani rishikuar në llog 602-Shpenzime operative	47,195,000
Plani i rishikuar në llog 606 – Fond i veçantë	+2,337,336
Plani në llog 605-transfera me jashtë	1,000,000
Plani në llog 231 -Investime kapitale	14,000,000
<b>Buxheti pas shtesave/pakësimeve gjatë vitit 2025</b>	<b>264,032,336</b>

Numri i punonjësve buxhetor i miratuar nga Ministria e Financave është 73 punonjës plus 2 punonjës (specialistë) me kontratë. Numri faktik i punonjësve të Gjykatës Kushtetuese në fund të periudhës raportuese është 72+1 punonjës. (44 punonjëse femra dhe 29 punonjës meshkuj).

### 3. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Numri i punonjësve të miratuar nga Ministria e Financave (MF) për vitin 2025 është 73 punonjës me kohë të plotë. Në fund të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ka 71 punonjës, nga të cilët 41 punonjëse janë gra, ndërsa 29 punonjës janë burra.

Në pozicionet drejtuese, aktualisht Gjykata Kushtetuese ka 1 Kryetare, 3 gjyqtare femra dhe 4 gjyqtarë meshkuj, 1 Sekretar të Përgjithshëm, 1 Drejtoreshë të Kabinetit të Kryetares, 3 Drejtoresha drejtorie, 2 Drejtorë drejtorie, 8 përgjegjëse sektori dhe 1 përgjegjës sektori (16 drejtuese femra dhe 8 drejtues meshkuj).

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2025 ka punësuar edhe 2 punonjëse (specialiste) me kontratë të përkohshme pune.

### 4. Performancë e buxhetit në nivel programi

Kodi i Programit: 03320

Emërtimi i programit: “*Veprimtaria gjyqësore kushtetuese*”

#### Qëllimet e Politikës së Programit:

Realizimi i veprimtarisë gjyqësore kushtetuese për garantimin e respektimit të Kushtetutës dhe interpretimit përfundimtar të saj, zgjidhja e mosmarrëveshjeve kushtetuese, në lidhje me ndarjen e pushteteve, ankesat e individëve, lidhur me cënimin e të drejtave kushtetuese, etj. nëpërmjet një procesi të drejtë ligjor dhe transparent.

**Përshkrimi i programit:** Realizimi i proceseve gjyqësore të drejta dhe transparent në mbrojtje të kushtetutës dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Veprimtaria gjyqësore kushtetuese është programi buxhetor i përbërë nga produktet:

- 93001AA**     **Produkti "Vendime të marra"**, nga 400 vendime të parashikuara për vitin 2025, janë realizuar 429 vendime për vitin 2025, ky produkt ka tejkaluar parashikimet.
- M300004**     **Produkti “Paisje zyre”**, i ndarë në mobilje/orendi dhe paisje elektrike zyre (kondicioner, tv, etj.) dhe është realizuar vetëm për mobilje/orendi, në masën 82%.
- M300008**     **Produkti “Rikonstruksion”** është realizuar në përputhje me kontratën e vitit 2025, fond i realizuar pothuajse në masën 100%.
- 18AG003**     **Produkti “Informatizim i veprimtarisë”** është realizuar në masën 19<sup>30</sup>% për 2 produkte (firewall dhe switch). Mos realizimi i produkteve të parashikuara ka të bëjë me procedurën e prokurimit për pjesën e pajisjeve kompjuterike (PC, laptop, fotokopje, ups etj), e cila për arsye objektive është përsëritur 2 herë gjatë vitit

2025 dhe aktualisht është në fazën e rivlerësimit të ofertave bazuar në vendimin nr.153/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

**M300007 Produkti “Biblioteka”,** është realizuar pjesërisht në masën 19<sup>30</sup>%, me blerjen e 28 titujve të rinj librash profesionalë (botime nga autorë shqiptar), ndërkohë që për arsye objektive (mungesë ofertash nga operatorë ekonomikë) nuk u arrit blerja e librave profesionalë nga autorë të huaj.

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik janë si më poshtë:

**Për artikullin 600- “Paga”,** me financim nga buxheti i shtetit fondi është realizuar në masën 100% për vitin 2025.

**Për artikullin 601- Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore,** fondi i akorduar është realizuar në masën 100% për vitin 2025.

**Për artikullin 602- Shpenzime operative,** realizimi për këtë zë është në masën 87%.

**Artikulli 605-Shpenzime për transferta korrente të huaja (605)** nga 1,000,000 lekë të akorduara për vitin 2025 dhe janë shpenzuar 503,241 lekë:

1. Kontributi financiar vjetorë për Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (*WCCJ*) në vlerën 101,500 lekë.
2. Kuotizacioni vjetor që paguan gjykata si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Gjykatave Kushtetuese Fronkofone (*ACCF*) në vlerën 234,266 lekë.
3. Kontributi financiar për pjesëmarrjen në Kongresin FIDE në vlerën 167,475 lekë.

**Artikulli 606- Shpenzime për transferta të brendshme,** nga 2,337,336 lekë, janë shpenzuar 1,672,597 lekë ose në masën 72%, për rimbursimet e shpenzimeve telefonike, pagesë për daljen në pension dhe pagesat kalimtare pas largimit nga funksioni të dy zyrtarëve.

Në mënyrë të përmbledhur buxheti i vitit 2025 prej 264,032,336 lekë të akorduara, gjatë vitit 2025 është realizuar në vlerën 251,757,089 lekë ose 95.4%.

## **5. Projektet kapitale –Investime kapitale**

Fondi total i akorduar nga buxheti i vitit 2025, për investimet kapitale është 14,000,000 lekë. Në këtë fond janë të përfshira investimet për të gjitha produktet e parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2025 nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Këtu përfshihen investimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës së brendshme të gjykatës, informatizimin e veprimtarisë, pasurimin e bibliotekës me tituj profesionalë, etj. Gjatë vitit 2025 janë kryer ndryshime (*rialokime fondesh*), brenda fondit të miratuar, me qëllim maksimizimin e realizimit të

produkteve të parashikuara. Këto ndryshime kanë marrë edhe miratimin e Ministrisë së Financave.

## **6. Ndryshimet në buxhet**

Gjatë vitit 2025, është çelur shuma 200,000 lekë nga fondi i vecantë në llog 606, si dhe janë akorduar në total fonde shtesë në vlerën 1,832,336 lekë për pagesat kalimtare pas largimit nga funksioni të dy zyrtarëve dhe daljen në pension. Brenda buxhetit të miratuar janë kryer rialokime në po këtë llogari, konkretisht, rialokim nga llog 602 në llog 606 në shumën 305,000 lekë për rimbursimet e shpenzimeve telefonike. Gjithashtu, janë kryer rialokime ndërmjet fondit të pagave dhe sigurimeve në shumën 1,705,000 lekë, si dhe riakolime fondesh ndërmjet produkteve tek investimet kapitale, llog 231.

## **7. Përfundimet**

Në përfundim të vitit raportues, realizimi i buxhetit në masën 95% reflekton një performancë të qëndrueshme financiare dhe një angazhim të vazhdueshëm për menaxhim profesional të fondeve publike. Gjatë gjithë vitit është zbatuar monitorim sistematik i ekzekutimit buxhetor, analizë periodike e shpenzimeve dhe rishikim i vazhdueshëm i projeksioneve financiare, me qëllim garantimin e disiplinës buxhetore dhe optimizimin e përdorimit eficient të fondeve. Mosrealizimi minimal i buxhetit prej 5%, lidhet me rrethana objektive gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, por kjo nuk ka ndikuar në përmbushjen e prioriteteve dhe objektivave institucionale. Në tërësi, menaxhimi financiar për vitin raportues vlerësohet efikas dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të financave publike. Gjatë vitit 2025 janë evidentuar faktorë të jashtëm, të cilët ndikojnë në realizimin e procedurave të prokurimit dhe për rrjedhojë kanë ndikim edhe në realizimin e produkteve, kryesisht në investimet kapitale. Gjatë vitit raportues nuk janë evidentuar faktorë të jashtëm ose të brendshëm të cilët mund të kenë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të vendosura dhe realizimin e produkteve në përputhje më programin “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**EUGEN PAPANILË**

